



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 18185 Prot.

Lezhë, më 04.11. 2025

VENDIM

Nr. 94, Datë 30. 10. 2025

PËR MIRATIMIN E HAPJES SË RRUGËS “BY-PASS-i I SHËNGJINIT”, NJËSIA ADMINISTRATIVE SHËNGJIN, BASHKIA LEZHË, NË FONDIN PYJOR BASHKIAK

Bazuar në Ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014, datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020 "Për Pyjet", në VKM-në nr.888, datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", VKM-në nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", udhëzimin Nr. 1, datë 26.01.2017 të Ministrit të Mjedisit "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor kombëtar" pas shqyrtimit të dokumentacionit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

Vendosi:

1. Miratimin e hapjes së rrugës "ByPass i Shëngjinit", Njësia Administrative Shëngjin, sipas projektit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Sipërfaqja që do të ndërtohet rruga detajohet si më poshtë:
 - 0.57 km rrugë me gjerësi 9 m, në ngastrën pyjore 33, ekonomia pyjore "Mali i Rrencit"
 - 0.87 km rrugë me gjerësi 9 m, në ngastrën pyjore 34a, ekonomia pyjore "Mali i Rrencit"
 - 0.37 km rrugë me gjerësi 9 m, në ngastrën pyjore 35c, ekonomia pyjore "Mali i Rrencit"
 - 0.30 km rrugë me gjerësi 9 m, në ngastrën pyjore 36a, ekonomia pyjore "Mali i Rrencit"
 - 0.63 km rrugë me gjerësi 9 m, në ngastrën pyjore 37a, ekonomia pyjore "Mali i Rrencit"

- 0.68 km rrugë me gjerësi 9 m, në ngastrën pyjore 40, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”
 - 0.67 km rrugë me gjerësi 9 m, në ngastrën pyjore 39a, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”
 - 0.19 km rrugë me gjerësi 9 m, në ngastrën pyjore 43b, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”
 - 1.26 km rrugë me gjerësi 9 m, në ngastrën pyjore 43, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”
 - 0.75 km rrugë me gjerësi 9 m, në ngastrën pyjore 45a, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”
 - 0.22 km rrugë me gjerësi 9 m, në ngastrën pyjore 46a, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”
 - 0.19 km rrugë me gjerësi 9 m, në ngastrën pyjore 46b, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”
 - 0.21 km rrugë me gjerësi 9 m, në ngastrën pyjore 47b, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”
 - 0.04 km rrugë me gjerësi 9 m, në ngastrën pyjore 47c, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”
 - 0.31 km rrugë me gjerësi 9 m, në ngastrën pyjore 52, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”
 - 0.32 km rrugë me gjerësi 9 m, në ngastrën pyjore 51a, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”
 - 0.09 km rrugë me gjerësi 9 m, në ngastrën pyjore 51b, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”
 - 0.06 km rrugë me gjerësi 9 m, në ngastrën pyjore 60b, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”
 - 0.66 km rrugë me gjerësi 9 m, në ngastrën pyjore 61a, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”
 - 0.12 km rrugë me gjerësi 9 m, në ngastrën pyjore 62a, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”
3. Për sipërfaqen që nevojitet për ndërtimin, të bëhet përditësimi kadastral duke pasqyruar vetëm zvogëlimin në volum dhe jo në sipërfaqe.
 4. Të bëhet rehabilitimi i sipërfaqes pyjore në skarpatat e rrugës që do të ndërtohet.
 5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
 6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI
NDUE LULI





Nr. 18185/1 prot
Dt: 07.11.25 K.B

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1059/4 Prot.

Lezhë, më 07.11.2025

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për prefektin e qarkut", nenin 54 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" të ndryshuar, ligjin nr 57/2020 "Për pyjet „VKM-në nr.888, datë 27.12.2022" Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", VKM-në Nr. 559, datë 29.7.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike dhe prodhimet drusore e jodrusore pyjore, si dhe mënyrën e procedurës së mbledhjes së tyre" i ndryshuar, si dhe në Udhëzimin nr. 1, datë 26.01.2017, të Ministrit të Mjedisit "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor kombëtar", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.94, datë 30.10.2025 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për miratimin e hapjes së rrugës "BY-PASS-i i Shëngjinit", njësi administrative Shëngjin, bashkia Lezhë në fondin pyjor bashkiak".

P R E F E K T I

Taulant MALSHI

